



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2024:102010

Datë: 17.03.2025

Numri i dokumentit: 07002150

C.nr.1571/2024

GJYKATA THEMELORE MITROVICË-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Skender Shala, në çështjen juridike kontestimore të paditësit N.H. nga Mitrovica, përfaqësuar nga avokatët Drilon Imeri dhe Elvir Imeri nga Mitrovica, kundër të paditurës QRK - MM - FSK , me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore, me objekt kontesti pagesën e kompensimit për ngritje në pagë sipas rregullores së(QRK), nr.02/2020, jashtë seance gjyqësore, më datë 17.03.2025, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit N.H. nga Mitrovica, ashtu që DETYROHET e paditura QRK - MM - FSK, me seli në Prishtinë, që paditësit në emër të kompensimit të diferencës në pagë për ngritje profesionale, për periudhën kohore 15.03.2021 – 31.06.2021, duke llogaritur diferencën nga 158.34€ në muaj, t’ia paguaj paditësit shumën prej 633.36€ me kamatë ligjore prej 8 % nga data 14.03.2024, si datë e paraqitjes së padisë, e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit ligjor.

II. REFUZHET si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit, sa i përket diferencës në pagë për periudhën kohore nga data 01.02.2020 deri me 14.03.2021, në shumën prej 2,058.42€.

III. DETYROHET e paditura QRK - MM - FSK , me seli në Prishtinë, t’ia paguajë paditësit shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë të përgjithshme prej 124 euro, të gjitha në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së Aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

Arsyetim

Paditësi, përmes të autorizuarit të tij, më datë 14.03.2024, ka paraqitur padi, te precizuar me dt. 04.07.2024 në këtë gjykatë, kundër të paditurës, për kompensim për ngritje në pagë, me vlerë të kontestit 2,533.44€.

Në padi ka theksuar se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura në pozitën OR6-Rreshter Shtabor. Ka shtuar se me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr.09/117 të datës 22.01.2020 është aprovuar Rregullorja Nr.02/2020 për Pagat, Shtesat mbi Pagë dhe Kompensimet tjera në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcën së Sigurisë së Kosovës. Bazuar në nenin 5, paragrafi 1 dhe 2 të kësaj Rregullore, ndërlidhur me shtojcën nr.1, ka theksuar se është përcaktuar që paga bazë sipas gradës së paditësit duhet të paguhet në shumën prej 782.23 euro, ndërsa paditësi për periudhën si në kërkesëpadi për këtë gradë është paguar në shumë prej 623.89 euro. Gjykatës i ka propozuar të aprovojë të bazuar kërkesëpadinë e paditëses dhe ta detyrojë të paditurën që në emër të kompensimit ngritjes profesionale me gradën (OR6 – Rreshter Shtabor), për periudhën 01.02.2020 deri me dt. 31.06.2021, t'ia paguaj diferencën në shumën prej 2,533.44€ si dhe kamatë ligjore prej 8% për që nga data e parashtrimit të padisë e deri në pagesën definitive. Si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar dhe atë në emër të përpilimit të padisë shumën prej 104 euro, si dhe në emër të taksës gjyqësore shumën prej 21 euro.

E paditura në përgjigje në padi ka deklaruar se e kundërshton në tërësi të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke theksuar se shërbimi në FSK është i rregulluar dhe përcaktuar me ligj të veçantë, ku janë përcaktuar të drejtat dhe detyrimet e pjesëtarëve të FSK-së, e nga ky ligj është përcaktuar se pagat, shtesat mbi pagë dhe llojet e tjera të kompensimit përcaktohen me akt veçantë nënligjor të nxjerrë nga Qeveria, ashtu që më datë 14.02.2020 është publikuar në Gazetën Zyrtare edhe rregullorja nr.02/2020 që përcakton këto kompensime, e aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Në mungesë të mjeteve buxhetore, që nga momenti i miratimit të rregullores, e njëjta nuk ka gjetur zbatim, prandaj me vendimin nr.10/21 të dt.28.07.2021 të Qeverisë së Kosovës është pezulluar shtojca e rregullores me të cilën janë përcaktuar pagat sipas gradave ushtarake dhe ekuivalenca e personelit. Ka konsideruar se kërkesa e paditëses është e parashkruar bazuar në dispozitat e nenit 341 dhe 342 të LMD-së dhe nenit 87 të LP-së, pasi që nga hyrja në fuqi e rregullores e deri në paraqitjen e padisë kanë kaluar më tepër se 3 vite. Lartësinë e kërkesëpadisë nuk e ka kontestuar. Gjykatës i ka propozuar të refuzojë të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike gjykata ka vlerësuar provat si në vijim: kontrata e punës e datës 21.01.2012, konfirmimi i punësimit i datës 11.12.2009, urdhër emërimi i datës 06.12.2019, urdhër avancimi i datës 24.08.2012, vendimi i datës 13.09.2021, vërtetim i datës 01.02.2024, transaksionet bankare për periudhën kohore 01.07.2021 deri 01.02.2024.

Gjykata pas vlerësimit të pretendimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartcekura në kuptim të nenit 8,398 dhe 399 të LPK-së, ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e aktgjykimit jashtë seance ashtu që me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku duke gjetur se kërkesëpadia e paditëses është pjesërisht e bazuar.

Me leximin e kontratës së punës të datës 21.01.2012, konfirmimi i punësimit i datës 11.12.2009, urdhër emërimi i datës 06.12.2019, urdhër avancimi i datës 24.08.2012, vendimi i datës 13.09.2021, vërtetim i datës 01.02.2024, transaksionet bankare për periudhën kohore 01.07.2021 deri 01.02.2024., gjykata vërtetoi faktin se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura që nga data 19.01.2012 dhe lartësia e pagës është 782.23€.

Gjykata për vendosje në këtë çështje kontestimore ka zbatuar dispozitat ligjore nga Ligji Nr.06/L-124 për Shërbim në Forcën e Sigurisë së Kosovës që në nenin 2 përcakton se “Ky ligj zbatohet për Forcën e Sigurisë së Kosovës, përfshirë pjesëtarët aktivë, rezervë, kadetët, rekrutët dhe personelin civil të saj” dhe nenin 11, paragrafi 1 dhe 3 se “*Të drejtën në pagë, shtesat mbi pagë dhe llojet tjera të kompensimit e kanë të gjithë pjesëtarët e FSK-së. Pagat, shtesat mbi pagë dhe kompensimet tjera, përcaktohen dhe paguhen në përputhje me dispozitat e përcaktuara me legjislacionin në fuqi, me akt të veçantë nënligjor të nxjerrë nga Qeveria*”. Akti i veçantë nënligjor është nxjerrë me Vendimin Nr.09/117 të datës 22.01.2020 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, në të cilin është përcaktuar se “*Aprovohet Rregullorja për pagat, shtesat mbi pagë dhe kompensimet tjera në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Ministria e Mbrojtjes dhe institucionet e tjera përgjegjëse*”.

Rregullorja nr. 02/2020 për pagat, shtesat mbi pagë dhe kompensimet tjera në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës, në nenin 5, paragrafi 1 dhe 2 përcakton se “*I gjithë personeli në MM dhe FSK kanë të drejtë në pagën bazë të gradës, të funksionit që kanë, Paga bazë përcaktohet për gradën, funksionin që bartë, në pajtim me Shtojcën nr. 1 bashkëngjitur dhe pjesë përbërëse e kësaj rregullore. Përcaktimi i pagës bazë bëhet me aktin e gradimit/emërimit*”.

në shërbim ose aktin e themelimit të marrëdhënies së punës”; ndërsa në nenin 22, shtojcën nr.1 – Tabela e pagave me rangun e gradave ushtarake dhe personelit civil ne MM dhe FSK përcakton se “Grada OR - 6, Rreshter Shtabor/ ka nivelin e pagës në shumën prej 782.23€.

Ndërsa, me Vendimin Nr.10/21 të datës 28.07.2021 të Qeverisë së Republikës së Kosovës është përcaktuar se *“Pezullohet përkohësisht së zbatuari neni 22 (Shtojca l) i Rregullores (QKR) Nr. 02/2020 për pagat, shtesat mbi pagë dhe kompensimet tjera në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës, deri në plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Obligohet Ministria e Mbrojtjes që sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi të përgatis dhe t’ia propozojë Qeverisë për miratim Projekt-Rregulloren për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores (QRK) Nr. 02/2020 për pagat, shtesat mbi pagë dhe kompensimet tjera në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës. Obligohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi”.*

Në bazë të nenit 87 të Ligjit të Punës, parashihet që *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës.”*

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjyqimit jashtë seance gjyqësore, bazuar në nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), në të cilën është përcaktuar se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritore, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”* dhe 399.1 që përcakton se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritore me të cilën refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”.*

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese gjendja faktike se që nga koha e hyrjes në fuqi të Rregullores Nr.02/2020 për pagat, shtesat në pagë dhe kompensimet e tjera – më datë 31.01.2020, e deri më datë 28.07.2021, kur e njëjta është pezulluar së zbatuari sa i përket shtojcës nr.1 për tabelën e pagave me Vendimin Nr.10/21 të Qeverisë së Kosovës, paditësi nuk është kompensuar sipas pagës së përcaktuar në nenin 22, shtojcën 1 të kësaj rregulloreje.

Gjykata, vlerëson se është i pabazuar arsyetimi i të paditurës se kjo rregullore nuk është zbatuar për shkak të mungesës së mjeteve buxhetore dhe se kjo ka qenë arsyeja pse kjo rregullore është pezulluar më pas. Gjykata, vlerëson se për periudhën kohore derisa nuk është pezulluar rregullorja sa i përket shtojcës nr.1 me vendim të qeverisë, e njëjta ka qenë në fuqi dhe ka prodhuar efekt juridik kështu që kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar, për shkak se e paditura nuk ka bërë ekzekutimin e Rregullores Nr.02/2020 për pagat, shtesat në pagë dhe kompensimet e tjera, gjatë kohës sa e njëjta ka qenë në fuqi, andaj duke marrë parasysh lartësia e pagës për paditësin sipas kësaj rregulloreje është paraparë të jetë 525.80€, ndërsa i njëjti pagën e ka pranuar në lartësi prej 382.15€ (në bazë të transaksioneve bankare të administruara si prova), rrjedh se diferenca në mes të pagës së pranuar dhe asaj të paraparë me rregulloren e lartcekur është në shumën prej 143.65€ dhe për 4 muaj rrjedh se obligimi i të paditurës ndaj paditësit është në lartësi prej 633.36€

Gjykata, vlerëson se kërkesa e paditësit është pjesërisht e parashkruar, për shkak se paditësi ka paraqitur padinë me datën 04.03.2024 dhe komfor nenit 87 të Ligjit të Punës, parashihet që *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës.”* Andaj, të gjitha kërkesa e paditësit që ka të bëjë me periudhën kohore para datës 14.03.2021 e deri me 01.02.2020 është parashkruar dhe atë në lartësi prej 2,058.42€.

Gjykata ka vendosur lidhur me shpenzimet procedurale bazuar në dispozitat ligjore nga neni 452 paragrafi 1 të LPK –së, sipas te cilit pala e cila humb kontestin ka për detyrë që t’i kompensoi shpenzimet gjyqësore, andaj gjykata marr për bazë vetëm ato shpenzime te cilat ishin te nevojshme për ndjekjen e çështjes ne gjykate, kjo sipas tarifës se OAK-ës, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit te padisë ne shumen 104 euro si dhe taksen gjyqësore ne shumen prej 20 euro gjithsejt 124 euro.

Nga të lartcekurat, bazuar në nenin 143, paragrafi 1 lidhur me nenin 398 dhe 399 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Numri i lëndës: 2024:102010
Datë: 17.03.2025
Numri i dokumentit: 07002150

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil

C.nr.1571/24, më datë 17.03.2025

Gj y q t a r i
Skender Shala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimet në Gjykatën e Apelit, përmes këtij Gjykate.